

REPUBLICA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development

Njësia Org. Mr. Prof. 585
Org. Jedin. Org. Unit NJPMNP Br. Prof. Prof. No:
Nr. i faqeve / Brej: stranic / No. pages: / Datum / Date: 21.03.2013
PRISHTINË/A

 N.H. Y.P. "IBER-LEPENC" Sh.A
D.D.

01-604 Dt. 18.03.2013
PRISHTINË - PRISTINA

NH IBER LEPENC SH.A.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare**

**për vitin që ka përfunduar më 31
Dhjetor 2012**

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

1

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

2

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

3

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKIUTET

4

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

5

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

6 - 23

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për bordin e drejtorëve të NH Ibër Lepenc Sh.a.

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të NH Ibër Lepenc Sh.a. (më tej referuar si "Ndërmarrja"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2012, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të liruar nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për kualifikim të opinionit, ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Ndërmarrjes në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ndërmarrjes. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezanti min e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Ndërmarrjes paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Ndërmarrjes më 31 Dhjetor 2012 dhe performansën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

BDO Kosova L.L.C.

BDO Kosova L.L.C.
Prishtinë, Kosovë
5 Mars 2013

NH IBËR LEPENC SH.A.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Me 31 Dhjetor 2012

	Nota	Me 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Me 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
ASETET			
Prona, Objektet dhe pajisjet tjera	4	137,973,064	141,901,679
Totali i asetëve fikse		137,973,064	141,901,679
Asete qarkulluese			
Paratë në arkë dhe Bankë	5	546,264	1,962,381
Depozitat me afat	6	1,025,000	25,000
Llogaritë e arkëtueshme	7	1,095,359	678,242
Te arkëtueshmet tjera	8	63,242	148,471
Inventari	9	1,252,493	1,226,352
Totali i asetëve qarkulluese		3,982,358	4,040,446
TOTALI I ASETËVE		141,955,422	145,942,125
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Kapitali Aksionar dhe Ekuiteti			
Kapitali	10	25,000	25,000
Rezervat e rivlerësuara	11	162,419,111	162,419,111
Humbja e bartur		(21,477,523)	(17,307,715)
Totali i Kapitalit dhe rezervat		140,966,588	145,136,396
Detyrimet Afatshkurtër			
Llogaritë e pagueshme	12	228,952	122,921
Detyrimet e tjera afatshkurtër	13	266,555	170,161
Total Detyrimet Afatshkurta		495,507	293,082
Detyrimet Afatgjate			
Te hyrat e shtyra	14	493,327	512,647
Total Detyrimet Afatgjate		493,327	512,647
Totali i Detyrimeve		988,834	805,729
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		141,955,422	145,942,125

Autorizuar për botim nga ana e bordit të drejtorëve më 5 Mars 2013

Ztr. Hajdar Beqa


 Kryeshef Ekzekutiv



Ztr. Sheremet Smakolli


 Zyrtar Kryesor Financiar

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 24 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

NH IBËR LEPENC SH.A.
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

	Nota	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Të Hyrat			
Të hyrat nga veprimtaria kryesore	15	3,705,259	3,610,631
Të hyrat nga donacionet	16	19,320	16,346
Të hyrat tjera	17	10,042	5,957
Total të Hyrat		3,734,621	3,632,934
Shpenzimet			
Shpenzimet e Zhvlerësimit	4	(4,590,974)	(4,548,798)
Shpenzimet e Personelit	18	(2,556,438)	(2,512,590)
Shpenzimet Operative tjera	19	(501,732)	(447,057)
Shpenzimet Administrative	20	(328,963)	(273,989)
Total shpenzimet		(7,978,107)	(7,782,434)
Humbja operative		(4,243,486)	(4,149,500)
Të ardhurat financiare	21	73,678	159,984
Humbja para tatimit		(4,169,808)	(3,989,516)
Tatimi në fitim		-	-
Humbja e vitit		(4,169,808)	(3,989,516)
Te hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i te hyrave gjithëpërfshirëse		(4,169,808)	(3,989,516)

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 24 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

NH IBËR LEPENC SH.A.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

	Kapitali Aksionar (në EUR)	Rezervat e Rivlerësuara (në EUR)	Humbja Bartur (në EUR)	Totali (në EUR)
Bilanci më 1 Janar 2011	25,000	162,419,111	(13,318,199)	149,125,912
Humbja e vitit	-	-	(3,989,516)	(3,989,516)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2011	25,000	162,419,111	(17,307,715)	145,136,396
Humbja e vitit	-	-	(4,169,808)	(4,169,808)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2012	25,000	162,419,111	(21,477,523)	140,966,588

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 24 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave
financiare.

NH IBËR LEPENC SH.A.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitet operative		
Fitimi/Humbja para tatimit	(4,169,808)	(3,989,516)
Zhvlerësimi	4,590,974	4,548,798
Humbja nga çregjistrimi i asetëve fikse	3,370	1,992
Fitimi para ndryshimit në asetet dhe obligimet operative	424,536	561,274
(Rritja)/Zvogëlimi në llogarit e arkëtueshme	(417,117)	1,186,805
Zvogëlimi/(Rritja) i të arkëtueshmet tjera	85,229	(98,962)
Rritja në stoqet	(26,141)	(283,377)
Rritja/(Zvogëlimi) në llogarit e pagueshme dhe detyrimet tjera afatshkurtra	202,425	(269,197)
(Zvogëlimi)/Rritja në të hyrat e shtyra	(19,320)	238,547
Paraja e gjeneruar ne operacionet	249,612	1,335,090
Paraja e gjeneruar prej aktiviteteve investuese		
Blerja e asetëve fikse	(665,729)	(2,158,064)
Rritja/zvogëlimi ne depozitat afatgjata bankare	(1,000,000)	1,000,000
Paraja e përdorur në aktivitetet investuese	(1,665,729)	(1,158,064)
Neto (zvogëlimi)/rritja e parasë dhe ekuivalenteve të parasë	(1,416,117)	177,026
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim të vitit	1,962,381	1,785,355
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fund të vitit	546,264	1,962,381

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 24 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

NH Ibër Lepenc Sh.a. ("Ndërmarrja") është shoqëri aksionare e inkuorporuar në Kosovë dhe e regjistruar sipas Regjistrimit të Bizneseve me numër regjistrimi 70465157 me datë 31 Dhjetor 2007. Adresa e zyrës së saj kryesore të regjistruar është: Sheshi "Bill Clinton" Nr. 13, Prishtinë, Kosovë.

Ndërmarrja është konstituuar në vitin 1986 si Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes të infrastrukturës së sistemit shumë funksional për furnizim me ujë. Më vonë është transformuar në Ndërmarrje Publike nga Misioni i UNMIK-ut. Në vitin 2007 me përfundimin e korporatizimit ndërmarrja ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore.

Ndërmarrja NH Ibër Lepenc Sh.a. në përputhje me ligjin numër 03/L-087 mbi Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore, aksionar i vetëm i së cilës është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kapitali fillestar i regjistruar i ndërmarrjes kap shumën prej 25 mijë euro.

Aseti kryesor i ndërmarrjes është Diga në Ujman e cila mundëson akumulimin e ujit i cili përdoret për prodhimin e energjisë elektrike, furnizimin e industrisë me ujë të papërpunuar për ftohje për KEK - Termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" si dhe Ferronikeli, ujësjellësit regional në Mitrovicë dhe Prishtinë dhe furnizimin e kooperantëve të bujqësisë me ujë për ujitje.

Akumulimi në digën e Ujmanit ka kapacitet prej 375 milion m³ ujë. Fillimisht uji nga diga përdoret për prodhimin e energjisë elektrike përmes Hidrocentralit me kapacitet të instaluar 35 MW duke shpenzuar mesatarisht 4 m³ për prodhimin e 1 kWh energji elektrike, pastaj uji akumulohet në basenin kompenzues në Pridvoricë i cili ka kapacitet prej 480.000 m³.

Nga baseni kompenzues i Pridvoricës uji pjesërisht shkarkohet në lum, me qëllim të ruajtjes të minimumit biologjik dhe sasia tjetër në kanalin kryesor me kapacitet fillestar prej 22 m³/sec, në gjatësi prej 50 km, nga ku furnizohen të gjithë shfrytëzuesit si industria, ujësjellësit dhe bujqësia.

Gjatësia e përgjithshme e kanaleve të hapura është 146,6 km ndërsa gjatësia e rrjetit nëntokësor të gypave është 766 km.

Infrastruktura e ndërmarrjes shtrihet në pjesën veriore dhe qendrore të Kosovës ku përfshinë këto komuna: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Kastriot, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Drenas.

Ndërmarrja NH Ibër Lepenc Sh.a. është e organizuar në dy njësi afariste:

1. Njësia afariste "Uji & Centrali elektrik",
2. Njësia afariste "Ujitja",

2 BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Interpretimet (ndryshe IFRS) të botuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) siç janë adaptuar nga Unioni Evropian ("IFRS të adaptuara").

2.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike përveç rastit të rivlerësimit të aseteve fikse.

2.3 Parimi i vazhdueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë. Siç tregohet në pasqyrat financiare, Ndërmarrja ka regjistruar një rezultat neto negativ për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012 në vlerë prej 4,170 mijë Euro që rezultoi me rritjen e humbjeve të akumuluarra më 31 Dhjetor 2011 në vlerë prej 17,308 mijë Euro në 21,478 mijë Euro më 31 Dhjetor 2012.

2.4 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën e tanishme

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e lëshuara nga Komiteti për interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë efektive për periudhën e tanishme:

Ndryshimet në SNK 24, Shpalosja e Palëve të Ndërlidhura (e lëshuar në Nëntor 2009 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas Janarit 2011). SNK 24 është rishikuar në 2009 për: (a) thjeshtëzimin e definicionit të palës së ndërlidhur, qartësimi i kuptimit të menduar dhe eliminimin e jo-konsistencës; dhe për (b) të ofruar përjashtim të pjesshëm për kërkesat për shpalosjen e entitete të lidhura me qeveritë. Si rezultat i standardit të rishikuar, Kompania tani gjithashtu shpalos dhe zotimet e kontraktuara për të blerë dhe shitur mallra dhe shërbime palëve të saja të ndërlidhura.

SNK 27 është ndryshuar duke qartësuar rregullat e tranzicionit për ndryshimet në SNK 21, 28 dhe 31 të bëra nga SNK 27 i rishikuar (siç është ndryshuar në Janar 2008); IAS 34 është ndryshuar që të shtojë shembuj të ngjarjeve të rëndësishme dhe transaksione që kërkojnë shpalosje në raportin e kondensuar interim, duke përfshirë transferet në mes niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë, ndryshimet në klasifikimin e aseteve financiare apo ndryshimet në mjediset e biznesit apo ekonomike të cilat afektojnë vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të entitetit.; dhe KIRF 13 është ndryshuar që të qartësojë matjen e vlerës së drejtë të kredisë. Ndryshimet e mësipërme kanë rezultuar në shpalosje shtesë apo të rishikuara, mirëpo nuk kanë pasur ndikim material në matjen apo njohjen e transaksioneve dhe balancave të raportuara në këto pasqyra financiare. Efekti financiar i kolateralit të nevojshëm për tu shpalosur nga ndryshimet e SNRF 7 është paraqitur në këto pasqyra financiare duke shpalosur vlerat e kolateralit veçmas për (i) ato asete financiare ku kolaterali është i barabartë me, apo e kalon, vlerën bartëse të asetit dhe (ii) ato asete financiare ku kolaterali është më i vogël se vlera bartëse e asetit.

2 BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.4 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën e tanishme (vazhdim)

Përmirësimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (lëshuar në Maj 2010 dhe efektive nga 1 Janari 2011) Këto përmirësime përbëhen prej një përzierje të ndryshimeve thelbësore dhe sqarimeve në standardet dhe interpretimet në vijim: SNRF 1 është ndryshuar (i) që të lejojë vlerën e bartur të GAAP të shfrytëzohet si kosto e konsideruar e një gjëje të pasuri, impiant dhe pajisje apo një mjeti të paprekshëm nëse ajo gjë është përdorur në operacione të rregullimit të normës, (ii) që të lejojë që rivlerësimi i shtyrë nga ndonjë ndodhi të përdoret si kosto e konsideruar e pasurisë, impianteve dhe pajisjeve edhe nëse rivlerësimi paraqitet gjatë një periudhe të mbuluar nga pasqyrat e para me SNRF si dhe (iii) të kërkojë adoptues që ti shpjegojë ndryshimet në politikat e kontabilitetit ose në përjashtimet e SNRF 1 ndërmjet raportit interim të parë me SNRF dhe pasqyrave të para financiare me SNRF, SNRF 3 është ndryshuar (i) të kërkojë matje në vlerën e saktë (përveç nëse ndonjë bazë tjetër për matje kërkohet nga ndonjë standard tjetër i SNRF) të interesave jo kontrolluese të cilat nuk janë interesa momentale pronësore apo nuk emërojnë mbajtësin me pjesë proporcionale të aseteve neto në rast të likuidimit, (ii) të ofrojë udhëzim për marrëveshjet e bazuara në aksione të blerësit e pagesës që nuk janë zëvendësuar, apo vullnetarisht janë zëvendësuar si rezultat i kombinimit të biznesit si dhe (iii) që të qartësojë se kontingjentet nga kombinimet e biznesit të cilat janë paraqitur para datës efektive të SNRF 3 të rishikuar (lëshuar në Janar 2008) do të llogariten në përputhje me udhëzimet e versioneve të mëparshme të SNRF 3; SNRF 7 është ndryshuar që të qartësojë disa kërkesa të shpalosjeve, në veçanti (i) duke shtuar theksim eksplicit në bashkëveprimin e shpalosjeve kualitative dhe kuantitative për natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve financiare, (ii) duke hekur kërkesën për të shpalosur vlerën bartëse të aseteve financiare të re negociuara të cilat përndryshe do ju kalojë afati apo do të zhvlerësohen, (iii) duke zëvendësuar kërkesën për shpalosje të vlerës së drejtë të kolateralit ma një kërkesë më të përgjithshme për të shpalosur efektin financiar të tij, si dhe (iv) duke qartësuar se një entitet duhet të shpalos shumën e kolateralit të përjashtuar të mbajtur në datën e raportimit, dhe jo shumën e fituar gjatë periudhës raportuese; SNK 1 është ndryshuar që të qartësojë kërkesat e prezantimit dhe përbërjen e pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet (ky ndryshim është adoptuar nga Kompania në pasqyrat e viteve të kaluara)

Standardet dhe interpretimet tjera efektive për këtë periudhë. KIRF 19 'Shlyerja e detyrimeve financiare me instrumente të ekuitetit, ndryshimet në SNK 32 në klasifikimin e çështjeve të të drejtave, qartësimi në KIRF 14 "SNK 19 - Kufizimi I definimit të një mjeti përfitimi, Kërkesat minimale të financimit dhe bashkëveprimi i tyre' që kanë të bëjnë me parapagimet dhe ndryshimet në SNRF 1 'Adoptimi për herë të parë i SNRF', nuk kanë pasur ndikim në këto pasqyra financiare.

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka shtyre në asnjë ndryshim në politikat e kontabilitetit të Kompanisë.

2 BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por që Kompania nuk i ka adoptuar

SNRF 9, Instrumentet Financiare Pjesa 1: Klasifikimi dhe Matja. SNRF 9 i lëshuar në Nëntor 2009, i zëvendëson ato pjesë të SNK 39 që kanë të bëjnë me klasifikimin dhe matjen e asetëve financiare. SNRF 9 më tej është ndryshuar në Tetor 2010 që të adresojë klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare dhe në Dhjetor 2011 për të (i) ndryshuar datën efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2015 dhe (ii) të shtojë shpalosje të tranzicionit. Karakteristikat kryesore të standardit janë si në fillim:

- Asetet financiare kërkohet që të klasifikohen në dy kategori matjesh: ato që duhet të maten më pas në vlerë të saktë, dhe ato që maten më pas në koston e amortizuar. Vendimi duhet marrë në njohjen fillestare. Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të entitetit për të menaxhuar instrumentet financiare dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë të instrumentit
- Një instrument matet më pas në koston e amortizuar vetëm nëse është instrument borxhi dhe (i) qëllimi i modelit të biznesit të entitetit është që të mbajë mjetet që të grumbullojë rrjedhën e kontraktuar të parasë, dhe (ii) rrjedha e kontraktuar e parasë së asetit paraqet vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit (kjo është 'karakteristikat themelore të borxhit'). Të gjitha instrumentet e tjera të borxheve duhet të maten me vlerë e saktë nëpërmjet fitimit apo humbjes.
- Të gjitha instrumentet e ekuitetit duhet të maten më pas në vlerën e saktë. Instrumentet e ekuitetit të cilat mbahen për tregti do të maten në vlerën e saktë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Për të gjitha investimet tjera të ekuitetit, mund që në njohjen fillestare të bëhet zgjidhje e pakthyeshme, që të njihen fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të porealizuara nëpërmjet të hyrave tjera gjithëpërfshirëse në vend se me fitim apo humbje. Nuk duhet të bëhet riciklim i fitimit apo humbjes me vlerë të drejtë në fitim apo humbje. Kjo zgjedhje mund të bëhet për çdo instrument veç e veç. Dividendët duhet të paraqiten në fitim apo humbje, përderisa paraqesin kthim në investim.
- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë bartur të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është se entiteti duhet të paraqes efektet e ndryshimit në reskun kreditor të detyrimeve financiare të caktuar në vlerën e saktë nëpërmjet fitimit apo humbjes në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse. Edhe pse adoptimi i IFRS 9 është i detyrueshëm nga 1 Janari 2015, adoptim më i hershëm është i lejuar.

SNRF 10, Pasqyrat financiare të konsoliduar (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), zëvendëson të gjithë udhëzimin në kontroll dhe konsolidim në SNK 27 'Pasqyrat financiare të konsoliduar dhe të veçanta' dhe SIC 12 'Konsolidimi - entitetet me qëllim të veçantë'. SNRF 10 e ndryshon definicionin e kontrollit ashtu që kriteret e njëjta aplikohen në të gjitha entitet që të përcaktohet kontrolli. Ky definicion mbështetet me udhëzim të gjerë të aplikimit.

SNRF 11, Marrëveshjet e përbashkëta, (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), zëvendëson SNK 31 'Interesat në Marrëveshjet e Përbashkëta' dhe SIC-13 'Entitetet e kontrolluara në mënyrë të përbashkët - Kontributet jo monetare nga ana e sipërmarrjeve'. Ndryshimet në definicione kanë reduktuar numrin e llojeve të marrëveshjeve të përbashkëta në dy: Operacionet e përbashkëta dhe Sipërmarrjet e përbashkëta. Politika ekzistuese e konsolidimit proporcional për entitetet e kontrolluara në mënyrë të përbashkët është eliminuar. Kontabiliteti i ekuitetit është i detyrueshëm për pjesëmarrësit në sipërmarrjet e përbashkëta.

2 BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por që Kompania nuk i ka adoptuar

SNRF 12, Shpalosja e Interesat në Entitetet tjera, (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2013), aplikohet tek entitetet të cilat kanë interes në ndonjë degë, marrëveshja të përbashkët, bashkëpunëtor ose në ndonjë entitet me strukturë të pa konsoliduar. Zëvendëson kërkesat e shpalosjes që për momentin mund të gjenden tek SNK 28 'Investime në pjesëmarrje'. SNRF 12 kërkon nga entitetet që të shpalosin informata të cilat ndihmojnë lexuesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën, rreziqet dhe efektet financiare lidhur me interesin e entitetit në degë, pjesëmarrje, marrëveshje të përbashkëta dhe entitete me strukturë të pa konsoliduar. Për të arritur këto qëllime, standardi ri kërkon shpalosje në një numër fushash, duke përfshirë gjykime dhe supozime të rëndësishme të bëra për të përcaktuar se një entitet kontrollon, bashkërisht kontrollon, apo ndikon në mënyrë të konsiderueshme në interesat e entiteteve tjera, shpalosje të zgjeruara në aksionet e interesave që nuk i kontrollon në aktivitetet grupore dhe rrjedhën e parasë, informacionin financiar të përmbledhur të degëve me interes jo kontrollues material, dhe shpalosje e detajuar e interesave në entitetet me strukturë jo të konsoliduar.

SNRF 13, Matja e drejtë e vlerës, (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), ka për qëllim përmirësimin e konsistencës dhe reduktimin e kompleksitetit duke siguruar përcaktimin e rishikuar të vlerës së drejtë, dhe një burim të vetëm të matjes së drejtë të vlerës dhe shpalosjen e nevojave për përdorimin e SNRF-ve.

SNK 27, Pasqyrat financiare të ndara, (rishikuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), ishte ndryshuar dhe tani qëllimi i tij është që të parashkruaj kontabilitetin dhe shpalos kërkesat për investime në degë, sipërmarrje të bashkuara dhe shoqata kur një entitet përgatit pasqyra financiare të ndara. Udhëzimi mbi kontrollin dhe pasqyrat financiare të konsoliduar ishte zëvendësuar nga SNRF 10, Pasqyrat financiare të konsoliduar.

SNK 28, Investimet në shoqata dhe sipërmarrjet e bashkuara, (rishikuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013). Ndryshimi i SNK 28 ka rezultuar nga projekti i Bordit mbi sipërmarrjet e përbashkëta. Gjatë diskutimit të atij projekti, Bordi kishte vendosur ta inkorporoj kontabilitetin për sipërmarrjet e bashkuara duke përdorur metodën e ekuitetit në SNK 28 sepse kjo metodë është e aplikueshme për të dyja sipërmarrjet e bashkuara dhe shoqatat. Përveç këtij ndryshimi, pjesa tjetër e udhëzimit ka mbetur e pandryshuar.

Shpalosjet - Transferet e asetëve financiare - Ndryshimi 7 SNRF (lëshuar në Tetor 2010 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2011). Ndryshimi kërkon shpalosje shtesë duke respektuar rritjen e ekspozimit ndaj rrezikut të asetëve financiare të transferuara. Ndryshimi përfshin nevojën për shpalosjen e klasës së asetit, natyrën, vlerën bartëse dhe një përshkrim të rreziqeve dhe shpërblimeve të asetëve financiare të transferuara tek një palë tjetër, ende mbetet në bilancin e entitetit. Shpalosjet janë po ashtu të nevojshme që t'i mundësojnë përdoruesit për të kuptuar shumën e çfarëdo detyrimi të lidhur, dhe lidhjen në mes të asetëve financiare dhe detyrimeve të lidhura. Ku asetet financiare nuk janë njohur, por entiteti është ende i ekspozuar ndaj rreziqeve dhe shpërblimeve lidhur më asetin e transferuar, shpalosje shtesë është e nevojshme për t'u kuptuar efektet e këtyre rreziqeve.

2 BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por që Kompania nuk i ka adoptuar

Ndryshimet në SNK 1, Prezantimi i Pasqyrave Financiare (lëshuar në Qershor 2011, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Korrikut 2012), ndryshon shpalosjen e artikujve të prezantuar në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet kërkojnë nga entitetet që të ndajnë artikujt në të hyrat tjera të gjithëpërfshirëse në dy grupe, duke u bazuar se a duhet apo jo të riklasifikohej në fitimin apo humbjen në të ardhmen. Titulli i sugjeruar i shfrytëzuar nga SNK 1 është ndryshuar në 'pasqyra e fitimit dhe humbjes dhe të hyrat tjera gjithëpërfshirëse'. Grupi pret që standardi i ndryshuar të ndryshojë prezantimin e pasqyrave financiare të tija, por nuk ka ndikim në matjen e transaksioneve dhe balancave.

SNK 19 i ndryshuar, Përfitimet e të punësuarve (lëshuar në Qershor 2011, efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), ka ndryshime të rëndësishme në njohjen dhe matjen përfitimeve të definuar të shpenzimeve të pensionit dhe ndërprerjes së kontratës, dhe në shpalosjen e të gjitha përfitimeve të të punësuarve. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në përfitimet neto të detyrimeve (aseteve) të përfitimeve kur paraqiten, si në vijim: (i) kosto e shërbimeve dhe interesat neto në fitim apo humbje; dhe (ii) ri matjet në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse.

Shpalosjet - Thyerja e Aseteve dhe Detyrimeve Financiare - Ndryshimet në SNRF 7 (lëshuar në Dhjetor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013). Ky ndryshim kërkon shpalosje të cilat do ti mundësojnë shfrytëzuesve të pasqyrave financiare të entiteteve të vlerësojnë efektin apo efektin potencial të thyerjes së marrëveshjeve, duke përfshirë të drejtën për thyerje. Ndryshimi do të ketë ndikim në shpalosje mirëpo nuk do të ketë efekt në matjen dhe njohjen e instrumenteve financiare.

Thyerja e Aseteve dhe Detyrimeve Financiare - Ndryshimet në SNK 32 (lëshuar në Dhjetor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2014). Ky ndryshim ka shtuar udhëzim të aplikacionit për SNK32 që të adresojë jo vazhdueshmërinë e identifikuar në aplikimin e disa kriterëve të thyerjes. Kjo përfshin qartësimin e kuptimit të 'momentalisht ka të drejtë ligjore për thyerje' dhe se disa sisteme të shlyerjeve bruto mund të konsiderohen ekuivalente me shlyerjet neto.

Standardet dhe interpretimet tjera të rishikuara: Ndryshimet në SNRF 1 'Adoptimi për herë të parë i SNRF', në lidhje me hiper-inflacionin e ashpër dhe eliminimin e referencave të datave të caktuara për disa përjashtime, nuk do të ketë ndikim në këto pasqyra financiare. Ndryshimi në SNK 12 'Tatimet mbi të ardhurat', të cilat prezantojnë një gjykim kundërshtues se një pasuri investuese e bartur në vlerën e drejtë është e mbuluar në tërësi nga shitjet, nuk do të ketë ndikim në këto pasqyra financiare. KIRF 20, Kostot e nxjerra në fazën e prodhimit të sipërfaqes së një miniere, konsideron kur dhe si të llogariten për dobitë që dalin nga nxjerrja e aktivitetit nga industria e minierave.

Kompania ka zgjedhur të mos adoptoj këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës efektive të tyre. Kompania parashikon se adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar. Kompania konsideron ndikimin e SNRF 9 dhe datën e aplikimit fillestar të tij.

2.6 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Ndërmarrjes është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

3.1 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjidhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë.

Asetet dhe detyrimet monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të aseteve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si diferencë ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit.

3.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve me 1 Janar 2008 deklarohen sipas koston së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi, përderisa artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera pas 1 Janarit 2008 deklarohen sipas koston minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi nëse ka pas.

Kostoja e vlerësuar paraqet vlerat fillestare të aseteve të vlerësuara nga Ndërmarrja me ndihmën e një konsulenti të pavarur (PC&A) më 31 Dhjetor 2007.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rrjedhin për Ndërmarrjen dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri.

Zhvlerësimi i aseteve llogaritet duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë koston e tyre ose shumën e rivlerësuar në vlerën e tyre të mbetur gjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit siç vijon:

Ndërtesat dhe objektet tjera	50 - 100 vite
Makineritë e rënda	10 - 50 vite
Pajisjet dhe inventari tjetër	5 - 10 vite

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korrigjohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

Ndërmarrja me politikat e pranuar të kontabilitetit lidhur me rivlerësimin dhe dëmtimin e mjeteve jo financiare kërkon në çdo datë të bilancit të gjendjes që zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve të rivlerësohen dhe rishikohen për dëmtim, kurdoherë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethanat tregojnë që vlera bartëse e një mjeti nuk mund të jetë e rikuperueshme. Siç është shpalosur në shënimin 4 të pasqyrave financiare shoqëruese, më 31 Dhjetor 2012 vlera neto bartëse e pronës, impianteve dhe pajisjeve është në vlerë prej 137,973 mijë EUR.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.3 Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuterë. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare përderisa kostoja e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

3.4 Asetet dhe detyrimet financiare

Asetet dhe detyrimet financiare që ndodhen në bilanc të gjendjes përfshijnë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat e kontabilitetit mbi njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse të kontabilitetit që janë të përfshira në këtë shënim. Ndërmarrja i klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet në përputhje me substancën e marrëveshjes së ndërlidhur kontraktuale. Interesat, fitimet dhe humbjet që lidhen me instrumentet financiare të klasifikuara si asete ose detyrime raportohen si të hyra ose shpenzime, respektivisht. Instrumentet financiare thyhen kur Ndërmarrja ka një të drejtë të zbatuar me ligj për të bërë thyerjen dhe ka për qëllim që ta zgjidh ose në baza neto apo që të realizojë asetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

3.5 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare njihen sipas vlerës së tyre reale dhe praktikohet provizioni për dëmtimet në llogaritë e arkëtueshme tregtare për shkak që Ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje që të mbledh të gjitha shumat që ia kanë borxh sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

3.6 Stoqet

Materialet, pjesët rezervë dhe materiali shpenzues, kryesisht lidhen me hidrocentralin, mirëmbajtjen e kanaleve dhe rrjetit të shpërndarjes së ujit, dhe vlerësohen sipas parimit të çmimit më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën FIFO dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara në sigurimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin dhe konditat ekzistuese. Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes në kursin e zakonshëm të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variabile të shitjes. Materialet dhe pjesët rezervë shpenzohen apo kapitalizohen me impiantet, sipas nevojës, kur të instalohen.

3.7 Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe në bankë. Për qëllime të rrjedhës së parasë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme paraqesin paratë e gatshme në dorë dhe depozitat në banka me periudhë maturimi prej 12 muaj ose më pak.

3.8 Huamarrjet

Huamarrjet paraqesin kreditë që janë marr nga institucionet financiare dhe qeveritare dhe maten sipas vlerës së tyre reale në kohën e njohjes fillestare dhe pas njohjes fillestare sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.9 Kostot e përfitimeve të pensionimit

Ndërmarrja nuk bënë provizionin dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve përveç atyre të paguara pranë Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

3.10 Tatimi

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me Ligjet tatimore të Kosovës që janë aktualisht në fuqi (Ligji nr. 03/L-162 i datës 29 Dhjetor 2009 “Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave”).

Ngarkesa për tatimin në të ardhura në pasqyrën e të ardhurave për vitin përmban tatimin aktual në të ardhura. Tatimi aktual llogaritet në bazë të profitit të tatueshëm që pritet për vitin duke përdorur shkallët tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Profiti i tatueshëm ndryshon nga profiti që raportohet në pasqyrën e të ardhurave për shkak se ai nuk përfshin zërat e të hyrave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme apo të zbritshme në vitet tjera dhe më tej ai nuk përfshin zërat që asnjëherë nuk tatimohen ose nuk janë të zbritshëm.

3.11 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga shitja e energjisë elektrike dhe ujitë përmbajnë vlerën e faturuar të energjisë elektrike dhe ujitë të dorëzuar. Faturimet për shitjet e energjisë elektrike dhe ujitë bëhen çdo muaj, me përjashtim të faturimit të ujitë për ujitje që faturohet një herë në vit.

3.12 Grantet

Grantet nuk njihen derisa të ekzistojë siguri e arsyeshme që Ndërmarrja do të respektojë kushtet e këtyre granteve dhe që ato grante do të pranohen.

Grantet kushti kryesor i të cilave është që Ndërmarrja duhet të blejë, ndërtojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë asete jo-rrjedhëse njihen si të hyra të shtyra në bilancin e gjendjes dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në bazë sistematike dhe racional përgjatë kohës së përdorimit të aseteve përkatëse.

3.13 Zotimet dhe kontingjentet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Një detyrim kontingjent shpaloet në të gjitha rastet përveç rasteve kur mundësia e rrjedhës së burimeve që paraqesin përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloet kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e një humbjeje kontingjente njihet si provizion nëse është e besueshme që ngjarjet në të ardhmen do të konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri më datën e bilancit të gjendjes dhe se mund të bëhen një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që pason.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.14 Gjikimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Ndërmarrjes

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, të cilat janë të përshkruara në Shënimin 3, nga menaxhmenti kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshëm nga këto vlerësime.

3.15 Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare:

Në rrjedhën normale të biznesit, Ndërmarrja bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u bazuar në këtë, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimi i rasteve ligjore:

Në rrjedhën normale të biznesit, Ndërmarrja bën një vlerësim për shumat që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Ndërmarrjes. Në bazë të këtij vlerësimi, ndërmarrja në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimi për çështjet ambientale, çaktivizimin dhe çështjet tjera të ndërlidhura

Aktualisht nuk ka asnjë kërkesë detyruese ligjore për mjedisin, çaktivizimin dhe dispozitat tjera të lidhura në Kosovë.

NH IBËR LEPENC SH.A.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

4 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

KOSTO/KOSTOJA E VLERËSUAR

	Objektet ndërtimore (në EUR)	Makineritë e renda (në EUR)	Pajisjet dhe inventari (në EUR)	Investimet ne vijim (në EUR)	Total (në EUR)
Më 1 Janar 2011	273,237,718	4,151,110	7,410,858	517,985	285,317,671
Shtesat gjatë vitit	1,520,795	-	186,606	450,663	2,158,064
Shitja, çregjistrimi gjatë vitit	-	-	(12,382)	-	(12,382)
Më 31 Dhjetor 2011	274,758,513	4,151,110	7,585,082	968,648	287,463,353
Shtesat gjatë vitit	682,285	-	73,287	(89,843)	665,729
Shitja, çregjistrimi gjatë vitit	-	-	(68,661)	-	(68,661)
Më 31 Dhjetor 2012	275,440,798	4,151,110	7,589,708	878,805	288,060,421
Zhvierësimi i akumuluar					
Më 1 Janar 2011	132,028,652	2,241,599	6,753,015	-	141,023,266
Amortizimi i vitit	4,344,699	83,022	121,077	-	4,548,798
Shitja, çregjistrimi gjatë vitit	-	-	(10,390)	-	(10,390)
Më 31 Dhjetor 2011	136,373,351	2,324,621	6,863,702	-	145,561,674
Amortizimi i vitit	4,373,810	83,022	134,142	-	4,590,974
Shitja, çregjistrimi gjatë vitit	-	-	(65,291)	-	(65,291)
Më 31 Dhjetor 2012	140,747,161	2,407,643	6,932,553	-	150,087,357
VLERA NETO E ASETEVE					
Më 31 Dhjetor 2012	134,693,637	1,743,467	657,155	878,805	137,973,064
Më 31 Dhjetor 2011	138,385,162	1,826,489	721,380	968,648	141,901,679

NH IBËR LEPENC SH.A.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

5	PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
	Paraja në arkë	947	1,526
	Paraja në bankë - në llogaritë rrjedhëse	545,317	460,855
	<i>Depozitat afatshkurta:</i>		
	Banka për Biznes	-	1,000,000
	Banka Ekonomike	-	500,000
		546,264	1,962,381

6	DEPOZITAT AFATGJATA/INVESTIMET	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
	Banka për Biznes	1,000,000	-
	Banka Ekonomike- Kapitali Aksionar	25,000	25,000
		1,025,000	25,000

Depozitat e Ndërmarrjes janë afatgjata me afat 2 vjeçar dhe janë me interes vjetor 6.2%.

7	LLOGARITË E ARKËTUESHME	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
	KEK- Shitja e Energjisë Elektrike	438,888	198,620
	KEK- Kosova B Shitja e ujit industrial	142,651	62,237
	KEK- Kosova A Shitja e ujit industrial	104,634	91,705
	KUR Mitrovica	134,223	111,881
	KUR Prishtina	18,081	26,529
	NEWCO Ferronikeli	32,669	50,710
	Ujitja- Ko-operantët Bujqësorë	239,621	151,969
	NSHP Komunalja	-	2,463
		1,110,767	696,114
	Provizioni për borxhet e këqija	(15,408)	(17,872)
	LLOGARIT E ARKETUESHME NETO	1,095,359	678,242

NH IBËR LEPENC SH.A.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

8 TË ARKËTUESHMET TJE RA

	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Banka Private për Biznes- Interesi i arkëtueshëm	39,439	101,667
Banka Ekonomike- Interesi i arkëtueshëm	7,289	36,223
Kërkesat ndaj punëtorëve	11,219	4,920
Avance (parapagimet)	4,713	5,661
Kërkesat tjera	582	-
	<u>63,242</u>	<u>148,471</u>

9 INVENTARI

	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Depo Komoran	504,347	535,880
Depo Shkabaj	356,368	362,782
Depo Vushtrri	350,390	285,257
Depo Ujman	29,180	29,180
Depo Shkabaj Teknika	11,828	12,872
Depo Drejtori	380	381
	<u>1,252,493</u>	<u>1,226,352</u>
Provizionet për vlerësimin e inventarit	-	-
VLERA NETO E INVENTARIT	<u>1,252,493</u>	<u>1,226,352</u>

10 KAPITALI AKSIONAR

Më 31 Dhjetor 2012 dhe sipas Regjistrimit të Biznesit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë më datë 31 Dhjetor 2007 me numër regjistrimi të biznesit 70465157, kapitali i përgjithshëm i regjistruar kap shumën e 25 mijë eurove. Ai përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me çmim prej 1 euro për aksion. Aksionari i vetëm i ndërmarrjes është Qeveria e Republikës së Kosovës.

11 REZERVAT E RIVLERËSUARA

Rezervat janë llogaritur në librat e Ndërmarrjes si ndryshim ndërmjet kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës neto të aseteve të Ndërmarrjes siç ishte përcaktuar nga vlerësimi i pavarur në datën e korporatizimit të saj si SH.A. (1 Janar 2008). Këto rezerva janë larguar në dispozicion të aseteve të lidhura. Më tej këto rezerva nuk janë në dispozicion për shpërndarje të aksionarëve.

NH IBËR LEPENC SH.A.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

12 LLOGARIT E PAGUESHME

	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	103,248	25,812
NNP Noti	27,415	29,835
NTSHN Arfa	23,730	23,730
KEK- Dispeqing Mitrovica	14,545	1,192
KEK- Dispeqing Prishtina	5,459	6,267
KAWA Sh.p.k.	9,233	-
Graniti Petrol	8,234	3,805
KOSTT	8,148	3,522
MAK Bulding	5,300	522
Trasing Group	4,934	-
Tre Kuartista	4,740	-
BG Inenjering	4,466	4,466
NNT ABC	4,242	-
PTK	1,387	886
Termokos	781	1,421
KUR Batllava	176	154
Allmakes Global Services	311	-
Menar Petrol	648	648
Asseco See	640	160
Eurostandard Company Shpk	200	-
Autoteknik Baholli	248	-
E.R.O. Prishtine	-	2,375
Xani-Inex	-	1,735
NNP Tosi	-	5,939
Rexha Shpk	-	10,049
Furnitorët tjerë	867	403
	228,952	122,921

13 DETYRIMET TJERA AFATSHKURTA

	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Pagat e pagueshme punëtorëve	134,272	-
Kontributet Pensional e të pagueshme	31,729	34,276
Tatimi në paga i pagueshme	26,909	29,303
Mëditjet e pagueshme anëtarëve të bordit	16,705	30,787
TVSH-ja e pagueshme	34,897	46,652
Tatimi në interes i pagueshëm	18,022	27,138
Detyrimet tjera afatshkurta	4,021	2,005
	266,555	170,161

NH IBËR LEPENC SH.A.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

14 TË HYRAT E SHTYRA	Më 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Donacionet- Gjendja fillestare	512,266	273,503
Donacion nga MBPZHR- Rehabilitimi S.P. Samadrezhe dhe LP 10kv Vushtrri-Barnovc-Samadrezhe	-	255,109
Të hyrat e shtyra të njohura	(19,320)	(16,346)
Total të hyrat e shtyra nga donacionet	492,946	512,266
Të hyrat e shtyra -Ujitja- Gjendja fillestare	381	597
Të hyrat e shtyra gjatë vitit	67,098	59,794
Të hyrat e shtyra të njohura	(67,098)	(60,010)
Total të hyrat e shtyra nga ujitja	381	381
TOTAL TË HYRAT E SHTYRA	493,327	512,647
15 TË HYRAT NGA VEPRIMTARIA	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Të hyrat nga shitja e energjisë elektrike	1,941,189	2,074,380
Të hyrat nga shitja e ujit industrial	1,554,899	1,352,527
Të hyrat nga shitja e ujit për ujitje	209,171	183,724
	3,705,259	3,610,631
16 TË HYRAT NGA DONACIONET	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Shërbimet e Përbashkëta	1,100	1,100
Njësia Teknika	2,400	2,400
Njësia Vushtrri	14,338	11,874
Njësia Shkabaj	1,195	686
Njësia Komoran	287	286
	19,320	16,346

NH IBËR LEPENC SH.A.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2012

17 TË HYRAT TJERA	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Të hyrat nga shlyerja e obligimeve	5,939	-
Të hyrat nga kthimi i borxhit të keq	2,649	-
Të hyrat tjera	1,454	5,957
	<u>10,042</u>	<u>5,957</u>
18 SHPENZIMET E PERSONELIT	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve	2,425,309	2,374,956
Kontributet Pensionale nga punëdhënësi	127,097	124,235
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	4,032	11,439
Shpenzimet shëndetësore	-	1,960
	<u>2,556,438</u>	<u>2,512,590</u>
19 SHPENZIMET OPERATIVE TJERA	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Shpenzimet e energjisë elektrike	241,902	137,893
Materiali shpenzues	110,277	100,060
Shpenzimet e derivateve	59,220	52,131
Shpenzimet për operim të sistemit të gjeneratorëve	36,489	44,745
Shpenzimet e mirëmbajtjes	32,159	93,207
Shpenzimet e telefonit	21,685	19,021
	<u>501,732</u>	<u>447,057</u>

20 SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Shpenzimet për kompensimet e drejtorëve bordit	107,120	100,456
Shpenzimet e taksave për leje	83,056	35,164
Shpenzimet për donacione dhe ndihmë humanitare	35,222	-
Shpenzimet e reprezentacionit	15,053	19,342
Shpenzimet e materialit të zyrës	14,182	11,467
Shpenzimet për konsultime dhe trajnime	13,457	13,550
Shpenzimet e anëtarësisë së sindikatës	9,766	9,635
Shpenzimet e regjistrimit të automjeteve	9,969	8,497
Shpenzimet gjyqësore dhe dëmet	4,461	13,082
Humbja nga shlyerja e mjeteve themelore	4,284	2,485
Shpenzimet e tatimit në pronë	2,364	2,322
Shpenzimet e provizioneve bankare	640	677
Shpenzimet e marketingut	551	1,151
Shpenzimet e borxheve të këqija	-	17,872
Shpenzimet e tjera	28,838	38,289
	328,963	273,989

21. TE ARDHURAT FINANCIARE

	Fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në EUR)	Fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në EUR)
Të hyrat nga interesi i depozitave në banka	71,278	157,784
Të hyrat nga kthimi i kredisë-Myzejen Jusufi	2,400	2,200
	73,678	159,984

22 TATIMI

Sipas Ligjit Nr. 03/L-162 të datës 29 Dhjetor 2009 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, tatimi në të ardhura do të jetë 10% për korporatat që nga data 1 Janar 2010 e më tutje (deri më 31 Dhjetor 2008 ishte 20%).

Humbjet e tatueshme mund të barten përpara për t'u shlyer në shtatë vitet e ardhshme pas vitit në të cilin humbja e tatueshme ishte shkaktuar. Gjatë vitit 2012 dhe viteve paraprake Ndërmarrja ka pësuar humbje të tatueshme. Nuk janë regjistruar provizione për tatime të shtyre mbi humbjet në të kaluarën apo për diferencat kohore për shkak të pasigurisë se kur apo nëse Ndërmarrja do të fillojë të krijojë profite të tatueshme.

Në vazhdimësi që nga rivlerësimi i asetëve fikse të bërë me 01.01.2008 me rastin e korporatizimit, ndërmarrja ka shpenzime shumë të larta të zhvlerësimit ku në vitin 2012 këto shpenzime kanë qenë 4,591 mijë euro. Kështu që edhe pse fitimi operativ përpara zhvlerësimit (OIBDA) është pozitiv, për shkak të shpenzimeve të larta të zhvlerësimit, ndërmarrja ka rezultat negativ dhe operon me humbje të vazhdueshme përpara tatimit.

23 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Rreziku kreditor

Ndërmarrja i nënshtrohet rrezikut kreditor nëpërmjet aktiviteteve të saja të shitjes. Në këtë respekt, rreziku kreditor për Ndërmarrjen buron nga mundësia që palët e ndryshme mund të mos paguajnë obligimet e tyre sipas kontratës. Shuma e ekspozimit kreditor me këtë rast përfaqësohet nga shumat e bartura të aseteve në datën e bilancit të gjendjes. Prandaj, llogaritë e arkëtueshme tregtare monitorohen në baza mujore dhe konsumatorëve u tërhiqet vërejtja me kohë.

Rreziku i tregut

Ndërmarrja nuk është futur në ndonjë transaksion të fiksuar për të mbuluar ekspozimin e saj ndaj lëvizjes së çmimeve që rrjedhin nga operacionet e saj.

Rreziku nga norma e interesit

Rreziku nga norma e interesit përbëhet nga rreziku që vlera e pasqyrave financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe nga rreziku i ndryshimit ndërmjet maturimit të aseteve që janë me interes dhe maturimit të detyrimeve që janë me interes dhe janë marr për të financuar ato asete. Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit në një instrument financiar është fikse tregon se deri në çfarë mase ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut nga norma e interesit.

Menaxhmenti beson se Ndërmarrja nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit në pasqyrat e saj financiare.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit reflekton paaftësinë e Ndërmarrjes për të siguruar fonde për të përmbushur angazhimet e saj. Menaxhmenti monitoron drejtpërdrejtë likuiditetin e Ndërmarrjes dhe pozitën e saj të rrjedhës së parasë. Kjo përfshin mirëmbajtjen e indikatorëve të likuiditetit të bilancit të gjendjes, koncentrimin e debitorëve dhe kreditorëve si në terma të përgjithshëm të financimit.

Rreziku nga kursi valutor i këmbimit

Rreziku nga kursi i këmbimit shfaqet kryesisht kur ekzistojnë llogari të arkëtueshme ose të pagueshme për shkak të transaksioneve me ndërmarrje të huaja. Megjithëkëtë, Ndërmarrja nuk është e ekspozuar ndaj ndonjë rreziku domethënës nga kursi i këmbimit për shkak se transaksionet kryhen në Euro.

Vlera reale e instrumenteve financiare

Vlera reale është shuma për të cilën një aset mund të këmbëhet apo një detyrim mund të shlyhen, ndërmjet palëve me vullnet dhe të mirinformuara në një transaksion duar lirë.

Menaxhmenti beson që vlera e bartur e të gjitha aseteve financiare dhe detyrimeve e reflektuar në pasqyrat financiare është e përafërt me vlerën e tyre reale.

24 NGJARJET PASUESE

Menaxhmenti nuk është në dijeni për ngjarje të cilët kanë të ngjarë pas datës së bilancit të gjendjes dhe që mund të kenë ndikim apo kërkojnë shpalosje në pasqyra financiare të Ndërmarrjes me datë 31 Dhjetor 2012.